



Pranuar / Received	28 - 03	2022	2	viti / god / year
Organ / Institucioni / Org / Unit	No / Nr / No / Part No	Shtesa / Annex / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKIMSAC	1642/2022		1/6	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.82/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.82/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] i përfaqësuar me autorizim nga Avokat [redacted] me adresë: [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit numër: 11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.82/2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me datë 02.02.2022.
- II. **MBETET** në fuqi Vendimi Nr.04/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës **Obligohet** që ankuesit t'ia bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi.
- III. **OBLIGOHET** Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë brenda afatit ligjor të bëjë sistemimin e ankuesit.
- IV. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës III të Dispozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Arsyetim

Ankuesi, [REDAKTUAR] me Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.09.2020 është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me mandat katër (4) vjeçar.

Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 10.11.2021 ka nxjerr Vendimin numër Nr.11/44, përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.09.2020, me ç' rast ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës-respektivisht ushtrimi i mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

I pakënaqur me Vendimin Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10.11.2021, ankuesi me datë 23.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër: 5593/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 06.01.2022 ka nxjerrë vendimin A.nr.953/2021 duke e shfuqizuar Vendimin Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10.11.2021 për shkak të metave ligjore të tij, ndërsa lëndën e ankuesit e ka kthyer në ri-shqyrtim tek Qeveria e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 21.01.2022 ka nxjerr Vendimin numër Nr.04/55, përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin e datës Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10.11.2021 sipas të gjeturave të vendimit të Këshillit dhe po ashtu e ka shfuqizuar edhe Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.09.2020 mbi bazën e të cilit ankuesi ishte emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me mandat katër (4) vjeçar

I pakënaqur me Vendimin Nr.04/55 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.01.2022, ankuesi me datë 02.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër:488/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 08.02.2022 ka kërkuar përmes e-maili prova shtesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 10.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këshilli me datë 14.02.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme/DMZP me shkresat e bashkangjitura të lëndës ndërsa me datë 16.02.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me qëllim të vendosjes në mënyre meritore ka nxjerr vendimin e datës 14.03.2020 me numër VK.nr.19/2022 përmes të cilit ankesës së ankuesit të datës 02.02.2022 me numër A.nr.82/2022 i ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 02.02.2022 me numër protokolli 488/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kopjen e publikimit të konkursit i datës 25.06.2019; Vendimin e Këshillit të datës A.nr.953/2021 të datës 06.01.2022; Vendimin numër Nr.04/55 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022; Autorizimin e datës 24.01.2022; Ankesën e ankuesit të datës 23.11.2021 me numër protokolli 5593/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Shkresën me përmbajtjen e portalit qeveritar për konkursin e datës 25.06.2020 me konkursin e bashkangjitur për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë



së Kosovës; Vendimin me numër Ref: VVMP 1555/20 i Gjykatës Kushtetues ndërlidhur me rastin nr.KO203/19 për vazhdimin e masës së përkohshme i datës 27.04.2021; Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.09.2020; Vendimin numër Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 10.11.2021, Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Autorizimin e përfaqësuesit-avokatit i datës 17.11.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 02.12.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 28.12.2021; E-mailin e datës 01.12.2021 dërguar nga Këshilli për A.K; E-mailin e datës 22.12.2021 dërguar nga Sh.L për A.K me korrespondencën e bashkangjitur; kërkesën për iniciimin e procedurës së rekrutimit e datës 19.06.2020 me numër:931; Kopjen e shpalljes së konkursit në gazetën Epoka e Re të datës 25.06.2020; Lista e kandidatëve pjesëmarrës në konkurs; Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër:763/2020 i datës 24.07.2021; Listën e ngushtë përfundimtare e datës 05.08.2020; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09 i datës 25.08.2020; Raporti i Komisionit për Vlerësimin e Kritereve i datës 25.08.2020; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër Nr.08/138 e datës 22.03.2017; Dëshminë për pranimin e aplikacionit e datës 06.07.2020; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 06.07.2020; Letër rekomandimin e datës 03.07.2020; Pasqyrën e llogarisë së trustit për ankuesin; Certifikatën e datës 30.06.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Klinë; CV-në e ankuesit; Diplomën e datës 09.07.1988 me numër:6689; Letër motivimi të datës 04.07.2020; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.02.2022; Përgjigjen në kërkesë të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 16.02.2022; Propozimin e datës 17.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për pikë të rendit të ditës; Deklaratën e pajtueshmërisë të datës 17.09.2020; Ekspozenë për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës; propozim vendimin për emërimin e ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.02.2022 dërguar nga DMZP/MPB; E-mailin e datës 08.02.2022 dërguar nga këshilli për znj. Propozimin për pikë të rendit të ditës e datës 06.012.2016; Deklaratën e pajtueshmërisë të datës 06.12.2016; Raportin e Komisionit për vlerësimin e kritereve i datës 30.11.2016; Dosjen e aplikimit të kandidatit [redacted] Dosjen e aplikimit të kandidatit [redacted] Dosjen e aplikimit të kandidatit [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është ***e bazuar pjesërisht, sepse:***

Kolegji, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.04/55 të datës 21.01.2022 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale me arsyetimin se të gjitha veprimet procedurale për rekrutimin e ankuesit janë bërë në pajtim me nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa vetëm shpallja dhe mbyllja e konkursit janë bërë sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, siç është i cekuar edhe në nenin 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në preambulën e Vendimit Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.09.2020 për emërimin e ankuesit në periudhë 4 (katër) vjeçare, e jo siç përcaktohet, me mandat 3 (tre) vjeçar me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurës ka gjetur se, Ministria e Punëve të Brendshme me datë 26.05.2020 kishte hapur konkursin për pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa i njëjti konkurs ishte mbyllur për aplikim me datë 09.07.2020. Me datë 24.07.2020 ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme kishte nxjerr vendimin Nr.763/2020 për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Kritereve, ndërsa Komisioni për Vlerësimin e Kritereve pas shqyrtimit të aplikacioneve me datë 05.08.2020 ka përcaktuar listën e ngushtë përfundimtare të



kandidatëve dhe të njëjtit me datë 25.08.2020 i janë nënshtruar intervistës, ku ankuesi në bazë të Formularit MAP-SHCK-09 për Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale si dhe raportit të Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve është vlerësuar me më së shumti pikë (487 pikë) dhe është renditur i pari.

Sekretari i Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 17.09.2020 i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kandidatit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, njërin nga 3 (tre) kandidatët më të vlerësuar sipas raportit rekomandues të Komisionit për Vlerësim të Kriterëve, për pozitën e lartë cekur, ku në mesin e tyre ankuesi ishte renditur i pari si më i vlerësuar, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 21.09.2020 ka nxjerr vendimin Nr.16/31 përmes të cilit ankuesin e ka emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me mandat 4 (katër) vjeçar.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës", Kolegji ka vlerësuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili sipas Aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO203/1 i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020, i cili ligj në nenin 85 ka përcaktuar se: "*Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj*", po ashtu në nenin 83 paragrafi 9 është përcaktuar se: "*Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri*", andaj mbi këtë bazë si dhe të gjeturave si më lartë, Kolegji ka konstatuar se përveç kërkesës për iniciimin e procedurës rekrutuese si dhe shpalljes së konkursit me datë 25.06.2020 të gjitha procedurat e tjera të rekrutimit për pozitën në të cilën ishte emëruar ankuesi, janë zhvilluar pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, të gjitha këto procedura janë zhvilluar sipas ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj mbi këtë bazë konstatimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është i bazuar dhe i njëjti është lënë në fuqi.

Mirëpo, në nenin 42 paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se: "*1. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton, me akt nënligjor, rregullat e hollësishme për zbatimin e këtij neni*" ndërsa akti nënligjor i kërkuar në mënyrë specifike nga ligji, sipas nenit 29 Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues përcaktohet që hynë fuqi: "*Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare*" ndërsa si datë për nënshkrim është përcaktuar 21.08.2020 nga rrjedh se vetë institucioni, respektivisht Qeveria e Kosovës nuk kanë arritur me kohë të hartojnë aktet nënligjore si në rastin konkret Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues e cila në mënyrë të detajuar i rregullon hapat dhe kriteret për procedurat e rekrutimit të Nëpunësve të Lartë Drejtues, përderisa ka pasur shume procedura të rekrutimit në proces në momentin e hyrjes së ligjit në fuqi, andaj sikurse ankuesi edhe kandidatët e tjerë kanë qenë të dëmtuar për shkak tej zgjatjes së afateve apo paqartësive ligjore në mungesë të akteve nënligjore, ndërsa ankuesi iu është përgjigjur hapave dhe kërkesave procedurale të rekrutimit ashtu siç kanë qenë të përcaktuara nga institucioni.

Qeveria e Republikës së Kosovës, qysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të parë Vendimit Nr.11/44 të datës 10.11.2021 dhe po ashtu edhe pas ri-shqyrtimit të lëndës së ankuesit sipas obligimeve ligjore të vendimit të Këshillit, e njëjta me Vendimin e datës 21.01.2022 me numër Nr.04/55 e ka shfuqizuar si në pikën 1 të dispozitivit vendimin e datës 21.09.2020 me numër Nr.16/31 të Qeverisë së republikës së Kosovës, përmes të cilit ankuesi asaj kohe ishte emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.



Me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 53 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: *“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj; 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm”*, andaj Kolegji konstaton se vendimi Nr.04/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022 nuk ka pasoja në të kaluarën, rrjedhimisht nuk ka pasoja para datës së nxjerrjes së tij me datë 21.01.2022 nga rrjedh se ankuesi nuk mundet që ta ushtrojë më tutje pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mirëpo i njëjti nuk e humbur të drejtën mbi statusin e fituar të nëpunësit civil, meqenëse vendimi Nr.04/55 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.01.2022 nuk ka efekt retroaktiv-prapaveprues.

Andaj, në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcaktohet se : *Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimi detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”* dhe po ashtu në pajtim me nenin 15 paragrafi të Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“1. Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale “*, Kolegji konstaton se meqenëse ankuesi e ka pasur të fituar statusin e shërbyesit civil deri në momentin kur ishte vendosur përfundimisht të shfuqizohet vendimi për emërimin e tij i datës 21.09.2020 me numër Nr.16/31 sipas Vendimit me numër Nr.04/55 i nxjerrë me datë 21.01.2022, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB obligohet që ankuesin Shpen Trdevaj ta emërojë në cilën do pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale nën kuadër të Shërbimit Civil në administratën shtetërore.

Po ashtu, kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 130 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”*, ndërsa ankuesi përkundër faktit që me datë 23.11.2021 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshill kundër vendimit me numër Nr.11/44 të datës 10.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe me datë 02.02.2022 pas ri-shqyrtimit të lëndës së ankuesit i njëjti ka parashtruar sërish ankesë brenda afatit ligjor kundër vendimit me numër Nr.04/55 të datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i njëjti ka vazhduar ti vuaj prodhimin e pasojave juridike të akteve të lartcekura përmes të cilave ankuesi është larguar nga marrëdhënia e punës respektivisht i është ndaluar paga, andaj mbi këtë bazë si dhe në mbështetje të nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 53 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, është i obliguar t’ia bëjë ankuesit në mënyrë retroaktive kompensimin e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas vendimit fillestar të datës 10.11.2021 me numër Nr.11/44 deri në momenti e zbatimit të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 53 paragrafi 2 dhe nenit 132 paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.82/2022

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit-Avokatit [REDACTED]
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Këshillit të Kosovës për Siguri
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit ;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik/MPB
- Arkivit të KPMSHCK-së

